



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E APELIMIT TATIMOR

Prot 01 Nr  
Dt 05.02.2018

Nr. 5734/3 Prot.

Tiranë, më 22.1.2018

Lënda: Vendimi i Drejtorisë së Apelimit Tatimor për ankimin e tatimpaguesit "Inter Trade & Distribution" shpk, me NIPT K91524002L, ndaj Njoftim Vlerësimit për detyrimet nr.11593 prot, datë 26.10.2017, nxjerrë nga DRT Tatimpaguesit e Mëdhenj

**"INTER TRADE & DISTRIBUTION", SHPK**  
**Kashar Mëzez, Autostrada Tiranë Durrës, km 1, Mëzes Fushë, Tiranë**

**DREJTORISË RAJONALE TATIMORE TATIMPAGUESIT E MËDHENJ**  
**Rruga "Presidenti George W.Bush"**

**V E N D I M**

Drejtoria e Apelimit Tatimor, në zbatim të kreu XIII të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", mori në shqyrtim kërkesën ankimore protokolluar me nr.5734 prot, datë 22.11.2017, që i përket:

**KËRKUES:** "Inter Trade & Distribution" SHPK me NIPT: K91524002L

**OBJEKTI:** Ankim ndaj Njoftim Vlerësimit për detyrimet nr.11593 prot, datë 26.10.2017, nxjerrë nga DRT Tatimpaguesit e Mëdhenj.

Me Njoftim Vlerësimin objekt ankimi janë njoftuar detyrimet si më poshtë:

Nr	Tatimi	Periudha	Gjoha (lekë)	Arsyet e detyrimit
1	TVSH	2017/01	180.000	Ligji 9920, datë 19.05.2008, neni 128/2
2	TVSH	2017/02	130.000	Ligji 9920, datë 19.05.2008, neni 128/2
3	TVSH	2017/03	110.000	Ligji 9920, datë 19.05.2008, neni 128/2
4	TVSH	2017/04	50.000	Ligji 9920, datë 19.05.2008, neni 128/2
5	TVSH	2017/05	80.000	Ligji 9920, datë 19.05.2008, neni 128/2
6	TVSH	2017/06	50.000	Ligji 9920, datë 19.05.2008, neni 128/2
7	TVSH	2017/07	60.000	Ligji 9920, datë 19.05.2008, neni 128/2
8	TVSH	2017/08	60.000	Ligji 9920, datë 19.05.2008, neni 128/2
	Total		720.000	

Bazuar në nenin 108 pika 2 të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar dhe pikës 108.2.1, të Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", i ndryshuar, DAT me shkresën nr.5734/1 prot., datë 03.01.2018, ka kërkuar nga



DRT Tatimpaguesit e Mëdhenj dokumentacion në mbështetje të ankimit.

DRTTM ka kthyer përgjigje me shkresën nr.11593/5 prot., datë 12.01.2018, protokolluar në DAT me nr.5734/2 prot, datë 15.01.2018.

Drejtoria e Apelimit Tatimor nga shqyrtimi paraprak i kërkesës për apelim konstaton se janë plotësuar kërkesat ligjore për marrjen në shqyrtim, kërkesa këto, të përcaktuara në Ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në R.SH-së” neni 106, 107 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.24, datë 02.09.2008, në zbatim të tij, pika 106 e në vijim konstaton se:

- Akti administrativ i ankimuar është objekt apelimi( neni 106 pika 1);
- Kërkesa për apelim është paraqitur brenda afatit ligjor (30 ditë kalendarike).
- Lidhur me kërkesën për pagimin e detyrimit tatimor, objekt ankimi, rezulton se akti administrativ objekt ankimi përmban vetëm gjobë, pagesa e të cilës nuk është kusht për marrjen në shqyrtim të ankimit (neni 107, pika 2 e ligjit të sipërcituar).

\* \* \*

DAT konstaton se me Njoftim Vlerësimin nr.11593 prot., datë 26.10.2017 tatimpaguesi është njoftuar për dënimin sipas aktit të vlerësimit të mbajtur nga zyra datë 03.10.2017. Sipas këtij vlerësimi nga kryqëzimi që ju bë faturave të shitjes së bëra nga subjekti për subjekte me NIPT-e me të dhënat e marra nga informatika për subjektet pasiv ose të çregjistruar vërejmë se subjekti ka kryer disa shitje dhe konkretisht për 72 fatura. Shitja me këtë subjekt është bërë në kundërshtim me nenin 44 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 në zbatim të tij pika 44/7. Në vijim, administrata tatimore ka dënuar tatimpaguesin, bazuar në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 128 pika 2 duke e dënuar me 10.000 lekë gjobë për çdo faturë, gjithsej në shumën 720.000 lekë.

\* \* \*

Tatimpaguesi kërkon anulimin e gjobës duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se procedura e ndjekur për lëshimin e Njoftim Vlerësimit është kryer në shkelje të detyrimeve ligjore të DRTTM duke i mohuar edhe shoqërisë të drejtën për të paraqitur kundërshtimet e tij. Dispozita ligjore e përdorur për vendosjen e dënimit është e gabuar. Sipas nenit 44/7 do të konsiderohen shkelje transaksionet e kryera nga tatimpaguesit në regjistrin pasiv të cilët nuk duhet të kryejnë transaksione shitje blerje. Shoqëria nuk është as në rolin e tatimpaguesit i cili kryen transaksione duke qenë në statusin pasiv as në rastin e një blerësi i cili blen te një tatimpagues pasiv i publikuar në listën e tatimpaguesve pasiv. Gjithashtu yhekson se në listat e subjekteve të publikuara nga DPT gjatë periudhës Jana-Gusht 2017 nuk rezulton asnjë subjekt nga ata të evidentuar si subjekte pasive nga ana e DRTTM. Në rast se kontrollohen këto emra në faqen zyrtare të QKB pjesa më e madhe e tyre rezulton akoma sot aktiv. Shoqëria pretendon se nuk ka asnjë mangësi apo pasaktësi në lidhje me informacionin që duhet të përmbajë fatura tatimore dhe çdo faturë është rregullisht e plotësuar dhe e lëshuar. Në këtë kuptim zbatimi i penalitetit nga ana e DRTTM duke pretenduar lëshimin e faturave me pasaktësi nga ana e shoqërisë është tërësisht i gabuar dhe abuziv. Pra e gjithë baza ligjore e përmenduar nga DRTTM për penalizimin e shoqërisë dhe procedura e ndjekur për lëshimin e Njoftim Vlerësimit janë të gabuara prandaj kërkojmë shfuqizimin e plotë të Njoftim Vlerësimit nr.11593 prot, datë 26.10.2017.



Pas shqyrtimit të pretendimeve të tatimpaguesit, dokumentacionit bashkëlidhur dhe akteve ligjore e nënligjore ku është bazuar dënimi i administratës tatimore, Drejtoria e Apelit Tatimor vlerëson se:

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, në nenin 44, pika 7 përcakton se *“Administrata tatimore qëndrore publikon në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe mban të përditësuar listën e tatimpaguesve që janë në regjistrin pasiv.*

*Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, që janë në regjistrin pasiv, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet në përputhje me këtë ligj”.*

Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008, i nxjerrë në bazë dhe për zbatim të ligjit, në paragrafin 44.7 përcakton se *“Administrata tatimore përditëson në mënyrë të vazhdueshme dhe publikon në faqen zyrtare elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, listën e tatimpaguesve, të cilët kanë kaluar në regjistrin pasiv, duke evidentuar emrin e tatimpaguesit dhe NIPT-in e tij.*

*Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë që janë në regjistrin pasiv, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet në përputhje me dispozitat ligjore.*

*Gjithashtu për çdo transaksion të kryer nga një tatimpagues blerës me një tatimpagues shitës që është në regjistrin pasiv, i publikuar në faqen zyrtare të tatimeve në listën e tatimpaguesve pasiv, konsiderohet shkelje si për shitësin dhe për blerësin dhe ky i fundit është përgjegjës bashkë me furnizuesin (shitësin) për pagesën e TVSH-së”.*

Këto dispozita ndalojnë kryerjen e transaksioneve nga tatimpaguesit të cilët ndodhen në regjistrin pasiv, sipas listës së publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, edhe pse këta subjekte mund të jenë aktiv në regjistrin e Qendrës Kombëtare të Biznesit. Referuar pikës I të nenit 44 të Ligjit për Procedurat Tatimore në RSH, transferimi në regjistrin pasiv nga administrata tatimore kryhet jo vetëm kur kërkohet nga tatimpaguesi pranë QKB-së, por edhe në rastet kur tatimpaguesi nuk ushtron veprimtari tregtare apo nuk dorëzon deklaratat tatimore për 12 periudha të njëpasnjëshme. Por, transferimi i tatimpaguesit në regjistrin pasiv kur nuk ushtron aktivitet apo nuk dorëzon deklaratat nuk pasqyrohet në regjistrin e QKB-së, por vetëm në regjistrin e administratës tatimore.

Pikërisht kjo është arsyeja që me Ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014, ligjvënësi ka ndryshuar nenin 44 të ligjit bazë, duke detyruar Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve që të publikojë në faqen zyrtare të saj regjistrin e tatimpaguesve pasiv dhe duke i dhënë një rëndësi të veçantë publikimit të kësaj liste.

Kjo listë është një ndër dokumentet kryesorë ku tatimpaguesi informohet në lidhje me statusin e tatimpaguesit tjetër me të cilin kryen një transaksion, pasi dënimi lidhet ngushtësisht me publikimin e transferimit të tatimpaguesit në regjistrin pasiv nga administrata tatimore dhe jo vetëm me faktin e kalimit të tij në regjistrin pasiv. Me qëllim vërtetimin në çdo moment të mëvonshëm se në çastin e kryerjes së transaksionit tatimpaguesi ka patur dijeni se tatimpaguesi tjetër me të cilin ka kryer transaksionin ka qënë i transferuar në regjistrin pasiv, çdo listë e publikuar më parë duhet të vijojë të qëndrojë e publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së



Përgjithshme të Tatimeve. Çdo përditësim nuk duhet të ndryshojë listën e mëparshme, por duhet të publikohet si një listë e re (që mund të përfshijë ose jo të dhënat e listës së mëparshme).

Në vijim të shqyrtimit të ligjshmërisë së dënimit, Drejtoria e Apelit Tatimor vëren se dënimi i zbatuar nga administrata tatimore është neni 128, pika 2 e Ligjit 9920/2008, ku përcaktohet se *“Tatimpaguesi, që lëshon një faturë tatimore me pasaktësi por që provohet se nuk ka efekt në llogaritjen dhe pagimin e detyrimit tatimor, dënohet me gjobë 10 000 lekë”*.

Pika 128.2 e Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, përcakton se *“Nese një tatimpagues lëshon një faturë tatimore të pasaktë në lidhje me informacionin që kërkohet të përmbajë në bazë të dispozitave të ligjit për procedurat tatimore ose të ligjeve të tjera tatimore në fuqi, por që është e sakte për sa i përket detyrimit tatimor, dënohet sipas paragrafit 2 të nenit 128 të ligjit për procedurat tatimore”*.

Sa më sipër, që të zbatohet dënimi sipas pikës 2 të nenit 128 të Ligjit për Procedurat Tatimore duhet të plotësohen detyrimisht dy kushte:

- Fatura duhet të jetë e pasaktë në lidhje me informacionin që kërkohet të përmbajë, dhe
- Fatura duhet të jetë e saktë për sa i përket detyrimit tatimor

Informacioni që duhet të përmbajë fatura tatimore përcaktohet në nenin 49, pika 3 të Ligjit për Procedurat Tatimore dhe nenin 101, gërma (ç) dhe (d) e Ligjit 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”. Sipas këtyre pikave, informacioni që duhet të përmbajë fatura tatimore përfshin ndër të tjera *numrin e identifikimit të TVSH-së të blerësit, sipas përcaktimit të nenit 92, të këtij ligji, kur ai është person i tatueshëm për furnizime brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe emrin e shitësit dhe blerësit”*.

Nga leximi i këtyre dispozitave, DAT vlerëson se fatura tatimore e cila ka të përcaktuar si blerës një tatimpagues që ndodhet në regjistrin pasiv të administratës tatimore nuk mund të konsiderohet automatikisht faturë e pasaktë për sa i përket informacionit tatimor që kërkohet të përmbajë. Dënimi i përcaktuar në pikën 2 të nenit 128 lidhet me pasaktësitë në aspektin formal të faturës, të cilat nuk ndikojnë në detyrimin tatimor që përllogaritet dhe paguhet mbi bazën e informacionit të kësaj fature. Një pasaktësi në faturë, e cila ndikon në detyrimin tatimor të llogaritur dhe deklaruar është përtej aspektit formal të saj dhe më së shumti duhet të konsiderohet një pasaktësi në aspektin përmbajtësor të faturës.

Në rastet kur administrata tatimore konstaton se tatimpaguesi - nëpërmjet faturave tatimore - ka deklaruar shitje ndaj tatimpaguesve që ndodhen në regjistrin pasiv, nëpërmjet mekanizmave të saj (përfshirë Drejtorinë e Hetimit Tatimor) duhet të verifikojë nëse veprimi është kryer për të fshehur shitjen reale të mallit/shërbimit apo shitja është kryer realisht ndaj personit të shënuar në faturë.

Nëse shitja është kryer realisht ndaj një tatimpaguesi që ndodhet në regjistrin pasiv, fatura nuk mund të konsiderohet e pasaktë në aspektin formal të saj, pasi NIPT-i i blerësit është i saktë dhe fatura nuk ka ndikuar në llogaritjen dhe deklarimin e tatimit (duke qënë se pasaktësia sipas



nenit 128/2 kërkon plotësimin në mënyrë kumulative të dy kushteve: pasaktësi në informacion dhe mosndikim në detyrimin tatimor). Administrata tatimore duhet të vijojë procedurat e përcaktuara në paragrafin 44.1.4 të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, duke i mbledhur detyrimin tatimor tatimpaguesit që është transferuar në regjistrin pasiv, ndonëse realisht ka qënë duke ushtruar aktivitet.

Ndërsa, nëse rezulton se në faturë është vendosur si blerës NIPT-i i një tatimpaguesi pasiv, i cili në të vërtetë nuk është pjesëmarrës në transaksion (faturë fiktive), atëherë fatura tatimore përmban pasaktësi në aspektin përmbajtësor të saj. Ashtu siç u tha më lart, pasaktësia sipas nenit 128/2 kërkon plotësimin në mënyrë kumulative të dy kushteve: pasaktësi në informacion dhe mosndikim në detyrimin tatimor.

Por, deklarimi i një blerësi joreal nuk mund të cilësohet si një faturë tatimore e pasaktë në lidhje me informacionin që përmban dhe që njëkohësisht nuk ndikon në detyrimin e tatimpaguesit. Nëse NIPT-i i shënuar në faturë i përket një tatimpaguesi me të cilin nuk është kryer realisht transaksioni, pikësëpari vlerësohet se pasaktësia e kësaj fature mund të ndikojë në përlllogaritjen dhe deklarimin e saktë të detyrimit tatimor pasi tatimpaguesi ka fshehur shitjen reale të kryer prej tij. Në të tilla raste, DAT vlerëson se tatimpaguesi ka lëshuar një faturë të pasaktë në aspektin përmbajtësor të saj, ku ekziston mundësia e ndikimit në llogaritjen e saktë të detyrimit të tatimpaguesit, pasi deklarimi i pavërtetë nuk mund të ketë tjetër qëllim përveç shmangies së detyrimit të saktë tatimor.

Arsyetimi i mësipërm vlen edhe për transaksionet e deklaruara me tatimpaguesit të cilët, referuar momentit të lëshimit të faturës kanë rezultuar me status kërkesë për çregjistrim apo të çregjistruar.

Sa më sipër, Drejtoria e Apelit Tatimor bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.Sh-së”, i ndryshuar, nenet 106, 107, 108 dhe Udhëzimin Nr.24, datë 02.09.2008 (i ndryshuar), në zbatim të tij, pika 108.3.3 gërma c),

## V E N D O S I

- Shfuqizim të aktit administrativ, objekt ankimi, Njoftim Vlerësimit për detyrimet nr. 11593 prot, datë 26.10.2017, nxjerrë nga DRT Tatimpaguesit e Mëdhenj

Në zbatim të pikës 3 të nenit 109 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në R.Sh”, vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor ose i Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore është i detyrueshëm për zbatim nga organi i administratës tatimore që ka bërë vlerësimin tatimor dhe nuk apelohej prej tij.

DREJTOR I APELIMIT TATIMOR

Mimoza Kalia

